



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.01.2021, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

(Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19 mbledhja zhvillohet me anë të mjetit të komunikimit elektronik Cisco Webex të instaluar në Kuvend. Kryetari i Kuvendit e drejton mbledhjen nga Kryesia e Kuvendit)

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i draftprogramit të punës së Kuvendit për periudhën 18 janar - 26 shkurt 2021.
2. Shqyrtimi i draftkalendarit të punimeve të Kuvendit për periudhën 18 janar - 5 shkurt 2021.
3. Shqyrtimi i draftkalendarit të paraqitjes në Kuvend të raporteve të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi - Kryetar i Kuvendit

Vasilika Hysi - Zëvendëskryetare e Kuvendit

Elisa Spiropali - Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin

Taulant Balla - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Nimet Musaj - Kryetar i Grupit Parlamentar të Pavarur

Edmond Stojku - Kryetar i Grupit Parlamentar Demokraci dhe Drejtësi

Rudina Hajdari - Kryetare e Komisionit për Integrimin European

Ulsi Manja - Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Mimi Kodheli - Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme

Alban Elezi - Zëvendëskryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat

Ermonela Felaj - Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare

Halil Jakimi - Zëvendëskryetar i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Enver Roshi - Kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Ramazan Gjuzi - Kryetar i Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Mungon:

Myslim Murrizi - Zëvendëskryetar i Kuvendit dhe Kryetar i Grupit Parlamentar Demokrat

Të pranishëm nga shërbimet e Kuvendit:

Merita Qato - Drejtore e Përgjithshme e Shërbimit Legjislativ

Aida Shllaku - Drejtore e Shërbimit të Seancës Plenare

Alkida Llakaj – Drejtore e Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi - Atëherë, përshëndetje të gjitha zonjave dhe zotërinjve anëtarë të Konferencës së Kryetarëve!

Gëzuar edhe një herë vitin 2021!

Në radhë të parë, me shëndet dhe me suksese, si në sesionin e ri dhe të fundit parlamentar, ashtu edhe në fushatën e ardhshme elektorale!

Më lejoni të bëj apelin, për efekt të kuorumit. Zonja Hysi, zoti Murrizi, zoti Balla, zoti Stojku, zoti Musaj, zoti Manja, zonja Kodheli.

Mimi Kodheli – Prezent.

Gramoz Ruçi – Zoti Elezi.

Alban Elezi – Prezent.

Gramoz Ruçi - Zoti Gjuzi,

Kujtim Gjuzi – Prezent.

Gramoz Ruçi – Zoti Jakimi, zoti Roshi,
Zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Prezent, Kryetar.

Gramoz Ruçi – Zonja Hajdari, zonja Spiropali.

Elisa Spiropali – Po, Kryetar.

Mirëdita!

Gramoz Ruçi – Atëherë, kuorumi është.

Hapim mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të Kuvendit. Në rendin e ditës kemi shqyrtimin e draftprogramit të punimeve të Kuvendit për periudhën 18 janar - 26 shkurt, shqyrtimin e draftkalendarit të punimeve të Kuvendit për periudhën 18 janar - 5 shkurt 2021 dhe shqyrtimin e draftkalendarit të paraqitjes në Kuvend të raporteve të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj për vitin 2020.

Shërbimet e Kuvendit janë kujdesur që t'i merrni materialet në rrugë elektronike. Draftprogrami, si gjithnjë, përfshin të gjitha çështjet e depozituara në Kuvend për shqyrtim, kurse draftkalendarit përfshin një pjesë të tyre.

Siç e dini, hapja e sesionit të ri parlamentar do të bëhet sipas kërkesës së Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Rregullores së Kuvendit, pra më 18 janar, që i bie ditën e hënë në orën 17:00. Seancat janë planifikuar për datat 28 dhe 4 shkurt 2021. Me çështjet që janë parashikuar për shqyrtim në këto data jeni njohur, pasi materialet ju janë vënë në dispozicion.

Prioritet paraqesin, veçanërisht aktet normativë me fuqinë e ligjit, për të bërë të mundur ratifikimin e tyre brenda afatit kushtetues 45-ditor.

Para se të shprehni mendimet tuaja, dua të ndalem fillimisht te një detyrim ligjor për Kuvendin, të parashikuar nga Kodi Zgjedhor dhe nga aktet nënligjore në zbatim të tij. Siç e dini, në nenin 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor, por edhe në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zbatim të këtij Kodi, parashikohet se: “Katër muaj para datës së zgjedhjeve, deri në formimin e qeverisë së re, ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e Kuvendit në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullatës të tilla, si: “1. Nismat që parashikojnë rritje të pagave, të pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale; 2. uljen ose heqjen e taksave; 3. faljen e kamatëvonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore ose doganore; 4. vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive apo të shpërblimeve”.”

Në rastet e mësipërme, pra nga të katër rastet e mësipërme përjashtohen këto raste: 1. Kur nisma kushtëzohet nga gjendja e fatkeqësisë natyrore ose epidemisë dhe pandemisë; 2. kur nisma ka qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar; 3. kur nisma ka si qëllim zbatimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

Çështja që dua të diskutoj me ju dhe të jepni mendime është se, sikurse e dini, në procedura parlamentare janë disa projektligje, të cilat përfshihen në kategorinë e nismave ligjore që KQZ-ja dhe Kodi Zgjedhor i ndalon së propozuari. Për lehtësi evidentimi në draftprogramin që keni marrë, kush e ka programin përpara, këto projektligje janë paraqitur me ngjyrë të verdhë).

Duke qenë se dispozita e mësipërme interpretohet në dy mënyra, për këtë arsye kërkoj mendimin tuaj nëse ky ndalim për të katër pikat që fola më lart përfshin të gjitha projektligjet tashmë në procedurë parlamentare prej disa muajsh apo vetëm projektligjet e propozuara pas hyrjes në fuqi të vendimit të KQZ-së; ky është problemi i parë.

Problemi i dytë që kam, ju kini përpara edhe draftkalendarin e paraqitjes në Kuvend të raporteve të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj për vitin 2020. Miratimi i këtij draftkalendari nga Konferenca e Kryetarëve është një detyrim procedural që buron nga neni 103 i Rregullores.

Këto kisha, si fillim, përpara se t'ju jap fjalën.

Dua t'ju them se zonja Hysi paska ardhur, e cila është gjithmonë korrekte, por sot erdhi me vonesë! Si profesoreshë... Domosdoshmëria e çan rrugën nëpërmjet rastësisë. Rasti është që sot kemi Konferencën e Kryetarëve, rastësi është që zonja Vasilika e ka emrin e para në listën e Konferencës së Kryetarëve dhe domosdoshmëri është që të gjithë ta urojmë zonjën Vasilika, e cila ka sot ditëlindjen. Gëzuar, zonja Vasilika!

(Deputetët urojnë zonjën Hysi për ditëlindjen.)

Vasilika Hysi – Faleminderit shumë!

Gramoz Ruçi – Kush e do fjalën lidhur me draftkalendarin 3 javor dhe kalendarin e raportimit të institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj?

Fjala për ju, zoti Balla.

Taulant Balla – Mirëmëngjesi!

Së pari, ju uroj të gjithëve gëzuar dhe një vit të mbarë!

Ky është sesioni i fundit parlamentar i kësaj legjislature. Bie tërësisht dakord me të gjitha çështjet që ju parashtruat dhe me prezantimin programit, qoftë të raportimit të institucioneve të pavarura, qoftë të punës së Kuvendit.

E uroj zonjën Hysi: gëzuar ditëlindjen! Pra, e fillojmë këtë Konferencë Kryetarësh me një urim.

Së dyti, që ka të bëjë me prerogativat e Kodit Zgjedhor, unë mendoj se Kuvendi duhet t'i ketë të përfshira në program dhe në kalendar, sipas të gjitha çështjeve, dhe të gjykojmë në vazhdimësi se cilat nga projektaktet, pra draftet që kemi në shqyrtim, hyjnë në juridiksionin apo në parashikimin e Kodit Zgjedhor. Unë mendoj se puna parlamentare nuk mund të preket nga parashikimet e Kodit, sepse janë të gjitha në proces. Megjithatë, futja në program dhe në kalendar nuk na pengon. Në rast se ndonjë nga projektaktet bie në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor, le ta vendosim në një konferencë të ardhshme të kryetarëve se cilat nga ato ligje hyjnë në ligjet që nuk mund të miratohen gjatë kësaj kohe, pra të hyrjes në afatin 4 muaj para zgjedhjeve.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Ju lutem!

Tjetër?

Urdhëroni, zoti Musaj!

Nimet Musaj – A më dëgjoni, zoti Kryetar?

Gramoz Ruçi – Po, po ju dëgjoj.

Nimet Musaj – U uroj të gjithë kolegëve gëzuar dhe juve, personalisht, Vitin e Ri 2021! E nisëm me një haber të mirë, pra me një ditëlindje, kështu që shpresoj që gjërat të na shkojnë kështu gjithë vitin.

E mbështes propozimin e kolegut Balla që t'i kemi në draftprojekt të gjitha amendamentet, propozimet dhe le t'i shikojmë hap pas hapi, duke ndjekur edhe propozimet që në fushatë elektorale nuk lejohet të veprojmë.

U uroj të gjithë kolegëve: gëzuar dhe mbarësi!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Tjetër?!

Urdhëroni, zonja Hajdari!

Rudina Hajdari – Edhe unë ju uroj gëzuar Vitin e Ri dhe një vit të mbarë për të gjithë!

Për sa i përket pikës që ngriti zoti Balla, besoj se ajo çfarë kërkon ligji është që të mos vazhdojmë me procedurat 4 muaj para zgjedhjeve, ndaj do të isha kundër këtij propozimi, sepse, duke parë ligjin, duket qartë që nuk mund të vazhdojmë dhe të vijojmë qoftë edhe me ato projektligje, për të cilat kanë nisur procedurat. Duke marrë parasysh që në momentin kur ato futen në procedurë kanë efektin e tyre dhe do të kenë një lloj ndikimi gjatë fushatës, gjatë zgjedhjeve, prandaj e kemi sanksionuar në ligj. Për të qenë të ndershëm dhe për të qenë të drejtë me të gjitha krahët e partive politike dhe me qytetarët shqiptarë, mendoj se do të ishte një gabim nëse ne vazhdojmë e vijojmë për të proceduar me ato projektligje, të cilat kanë këtë efekt dhe ndikim në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Ndaj, për të qenë etikë në atë që ne vetë e kemi miratuar me ligj dhe e kemi futur në Kodin Zgjedhor, duhet të stopojmë, të ndalojmë çdo projektligj që e ndalon Kodi Zgjedhor. Po ashtu, t'i përjashtojmë të gjitha ato projektligje që kanë nisur procedurën, sepse tashmë ne jemi futur në muajin janar dhe na ka mbetur gati 100 e ca ditë deri në datën e zgjedhjeve, ndoshta jemi diku te 3 muaj e pak, me llogaritë që bëjmë. Ndaj, nëse kjo nuk bëhet, ju garantoj se do të vazhdoj dhe do të ankojem për këtë gjë në të gjitha institucionet ndërkombëtare, do t'i shikoj me vëmendje të gjitha projektligjet që japin favor të pajustificueshëm dhe të padrejtë ndaj maxhorancës, apo kujtdo partie politike, edhe jashtë parlamentit, në mënyrë që t'i përdorin këto projektligje, këto kontrata, të cilat favorizojnë në mënyrë të pandershme garën politike dhe

zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Ndaj të jeni të sigurt që do ta shoh me shumë vëmendje, duke marrë parasysh që vij nga një subjekt i vogël dhe është e padrejtë që ne të jemi në një disfavor të pandershëm, ndërkohë që kemi qenë ne që e kemi miratuar atë Kod Zgjedhor, duke marrë parasysh edhe precedentët e kaluar që na kanë dëmtuar dhe kanë deformuar vullnetin e popullit dhe zgjedhjet parlamentare.

Kështu që, zoti Kryetar, kjo ishte ajo që doja të thosha.

Edhe një herë faleminderit për mundësinë që më dhatë fjalën dhe ju uroj të gjithëve një sesion të mbarë!

Gramoz Ruçi – Tjetër?

Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Ndoshta zonja Hajdari nuk e kuptoi çfarë thashë dhe më vjen keq. Nëse zonja Hajdari ka ndonjë propozim konkret se cili nga ligjet, është e mirëpritur ta thotë, por jam i sigurt që nuk di ta thotë, sepse asnjëri nga ne nuk di të thotë pa u shqyrtuar në komisione, apo pa lexuar raportet e komisioneve përkatëse se cili nga ligjet mund të hyjë nën parashikimet e Kodit Zgjedhor. Të hyjë në program dhe të hyjë në kalendar është një gjë dhe të votohet në seancë plenare është një gjë tjetër, po e them këtë edhe për shkak të eksperiencës parlamentare. Prandaj ne nuk mund të paragjykojmë sot, por komisionet parlamentare, dhe, në këtë këndvështrim Komisioni për Çështjet Ligjore, është filtri i vetëm që mund të na thotë se cili nga këto hyn nën parashikimet e Kodit Zgjedhor. Jam i sigurt se zonja Hajdari nuk e di sot se cili nga ato ligje, madje as unë nuk e di, prandaj të mos marrim përsipër të bëjmë politikë në Konferencën e Kryetarëve, por të bëjmë punën që i takon Kuvendit.

Unë nuk besoj se ndonjëri nga kolegët dhe anëtarë të Konferencës së Kryetarëve mendon që tashmë Kuvendi i Shqipërisë nuk duhet të punojë më, sepse kemi hyrë 4 muaj para zgjedhjeve. Kjo jo vetëm që nuk ndodh në asnjë vend, por Kuvendi i Shqipërisë është i detyruar ta vazhdojë punën e tij dhe, për ata që nuk e dinë, ky Kuvend e mbaron mandatin e tij dy muaj para datës 9 shtator, nuk e ka mbaruar mandatin e tij në datën 24 dhjetor. Puna parlamentare duhet të vazhdojë. Miratimi i çdo akti që bie në kundërshtim me Kodin Zgjedhor pa dyshim, për ata që nuk marrin vesh nga jurisprudenca, është Kushtetuta, janë ligjet me shumicë të cilësuar, ku edhe Kodi Zgjedhor, në aspektin hierarkik, hyn aty dhe pastaj janë ligjet e tjera. Në asnjë rast Kuvendi nuk do të marrë ndonjë vendim që bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe me Kodin Zgjedhor. Këtë thashë dhe besoj se isha i qartë dhe zoti Musaj më kuptoi.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Ju lutem, mos bëni replika me njëri-tjetrin, sepse nuk jemi në seancë këtu.

Urdhëroni, edhe një herë, zonja Hajdari!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Kryetar!

Nuk dua të bëj replikë, por thjesht t'i përgjigjem zotit Balla, i cili tha: "Nuk e kuptova çfarë tha". Dua t'u referohem projektligjeve që ju përmendët në fillim të Konferencës, unë jam dakord që ne duhet të vazhdojmë me punën parlamentare dhe këto projektligje të futen në kalendar, por ajo çfarë thashë unë (ndoshta nuk isha e qartë), është që ne të mos miratojmë projektligje, të cilat favorizojnë, në mënyrë të padrejtë, partitë politike gjatë fushatës zgjedhore, duke marrë parasysh që jemi më pak se 4 muaj larg zgjedhjeve parlamentare. Nëse këto projektligje që futen në kalendar dhe miratohen në parlament, favorizojnë në mënyrë të njëanshme një parti politike, atëherë ne duhet të mos e lejojmë këtë gjë, sepse prandaj e kemi sanksionuar me Kodin Zgjedhor duke marrë parasysh praktikat e shëmtuara të së kaluarës. Nëse vërtet mundohem të flas drejt, unë nuk po bëj politikë; kjo është e kundërta e asaj që po bëj.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Kush e do fjalën? Po, zoti Roshi.

Enver Roshi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryetar, gëzuar Vitin e Ri dhe Vasilikës i uroj gëzuar ditëlindjen!

Dua të them që roli ynë si deputetë është të jemi në shërbim të njerëzve dhe në shërbim të popullit, prandaj besoj se nuk ka ligj që të mos ketë impakt në jetën e përditshme të njerëzve. Ne si deputetë duhet ta ushtrojmë këtë funksion përderisa njerëzit kanë shumë problematika. Të mos harrojmë se jemi në një situatë shumë të vështirë nga pandemia e COVID 19, prandaj duhen bërë ndryshime të herëpashershme, si në aktet normative, por edhe në ndonjë ligj që mund të vijë më vonë për t'i dhënë një ndihmë më të shpejtë luftës kundër pandemisë. Është pak e vështirë për ta ndarë, se cili është pa efekte dhe cili është me efekte përderisa çdo ligj bëhet për të pasur një impakt për jetën e njerëzve. Ne nuk bëjmë ligje që janë jashtë në atmosferë, bëjmë ligje për njerëzit. Ne duhet të seleksionojmë ato ligje që janë vërtet në ndihmë të njerëzve dhe duhet t'i bëjmë, sepse janë grupet vulnerable dhe njerëz në nevojë që presin. Pra, ka disa gjëra që ne duhet t'i shikojmë me prioritet. Këtë nuk e them për të favorizuar ndonjë parti politike, por e them për të qenë në shërbim të njerëzve.

Së dyti, zoti Kryetar, dua të them që, meqenëse deputetët janë në risk të lartë, për shkak të takimeve me njerëzit dhe për shkak të grumbullimeve që do të kemi në komisione, të hartohet një listë për ne, edhe për ata deputetë që nuk e kanë kaluar e për grupe të tjera, që të mos preken deputetët nga COVID-i, që të vaksinohemi, të jemi në grupet prioritare, jo para atyre që janë në frontin e luftës, por në vijën e dytë apo të tretë të përfshihen deputetët për t'u vaksinuar me vaksinën anti-COVID.

Dua të përgëzoj nismën për fillimin e procesit të vaksinave në Shqipëri.

Edhe një herë gëzuar!

Gramoz Ruçi – Ka tjetër? Nuk ka.

Kush është dakord me programin e punës së Kuvendit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet dhe i njoftohet seancës.

Kush është dakord me draftkalendarin 3 javor dhe kalendarin e raportimeve? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Lidhur me debatin që u zhvillua këtu, të jemi të qartë për një gjë: së pari, ligjin e kemi miratuar ne dhe të mos bëjmë tani komente sikur disa duan ta zbatojnë dhe disa jo. Ligji është ligj, se e kemi miratuar ne.

Për sa i përket seriozitetit për këtë çështje, ju thashë që në krye të herës, sa e hapa mbledhjen: keni përpara draftprogramin, po jua tregoj dhe me të verdhë janë të gjitha nismat që përfshihen në ndalimin e parashikuar nga kodi zgjedhor dhe akti nënligjor i KQZ-së. Dakord? Prandaj, nuk ka ndonjë hezitim që Kuvendi do të zbatojë ligjin apo nuk do ta zbatojë atë. Ju thashë edhe rastet, për të cilat ndalohet, që e kemi miratuar vetë, dhe ju thashë rastet për të cilat lejohet. Nëse do të kemi ndonjë rast, ne miratojmë vetëm kalendarin për 2 javë që do të zhvillojmë seancën. Në këtë kalendar që miratuam, nuk është asnjë nga këto ligje që janë shënuar me të verdhë, që i ndalon ligji, që i ndalon Kodi, i ndalon vendimi i KQZ-së. Ne do të rimblidhemi përsëri pas 3 javësh, ku do të miratojmë kalendarin për 3 javët e tjera dhe përsëri do të gjykojmë për logjikën e zbatueshmërisë si të ligjit, të Kodit Zgjedhor, po ashtu edhe të akteve normative që ka nxjerrë KQZ-ja. Prandaj, të mos kemi asnjë problem lidhur me këtë çështje.

Çështja e dytë që doja të trajtoja në Konferencën e Kryetarëve: është paraqitur nga qeveria një akt normativ. Ky do të jetë pjesë e programit.

Akti normativ ka të bëjë me miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin, për furnizimin dhe nëpërmjet kompanisë së vaksinës së Covid-it dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtim, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave anticovid në Republikën e Shqipërisë, si dhe përdorimin e tyre për popullatën”.

Ky është akti normativ, i cili do të shqyrtohet dhe do të miratohet sipas procedurave parlamentare.

Pse e parashtroj këtë çështje?

E parashtroj se kjo marrëveshje është e panegociueshme dhe është kërkuar, që marrëveshja të lidhet me konfidencialitetin, pra është sekret. Pra, kërkon mospublikimin e marrëveshjes për

shkak të sekretit tregtar, që kjo marrëveshje të mos publikohet, duke filluar që nga mjetet e shtypit apo faqet e Kuvendit, siç është rasti konkret dhe deri te fletoren zyrtare, si dhe të gjitha institucionet e përfshira në dhënien e mendimit, miratimit apo që janë pjesë e procesit, kanë detyrimin të mos bëjnë publike marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ, apo pjesë të saj. Është pjesë e marrëveshjes.

Sigurisht, deputetët nuk do të votojnë qorrazi. Do të njihen me aktin normativ, do të njihen me relacionin, do të njihen edhe me marrëveshjen. Çështja është që marrëveshja nuk do të botohet në faqen zyrtare. Marrëveshja do të jetë e depozituar si marrëveshje sekret, brenda të gjitha rregullave që përbën sekretin dhe konfidencialitetin e gjërave. Deputetët do të vinë, kush është i interesuar, të njihet me marrëveshjen në komisionin përkatës, duke pasur një kopje atje, do të bëjnë diskutimin përkatës online, pasi ta njohin marrëveshjen dhe, sigurisht, në seancë plenare do të japin edhe mendimin e tyre, edhe votën e tyre.

A jemi të qartë për këtë çështje? Këtë doja t'u komunikoj kryetarëve të komisioneve.

Shërbimet e Kuvendit do t'ua bëjnë të qartë kryetarëve të komisioneve përgjegjëse se si bëhet njohja në rastin e dokumenteve, kur kërkohet konfidencialitet dhe sekret i cilësdo natyre qoftë, me qëllim që të mos kemi probleme ne si Kuvend.

Dakord?

Atëherë, këtu mbyllet mbledhja.

Faleminderit!

Mirupafshim ditën e hënë në orën 17:00!

Sigurisht, aty do të miratohet programi, do të miratohet kalendari, do të ketë një fjalë nga ana ime, sipas traditës, për të bërë një bilanc për fillimin e sesionit të ri parlamentar dhe deri në 10 minuta kryetarët e grupeve, kush dëshiron të marrë fjalën.

Ditën e mirë!

(MBLEDHJA MBYLLET)